2	Arsimi Parashkollor	1	3	0	4

3	Arsimi Special	4	65	11	79
4	Art Pamor	0	1	3	4
5	Art pamor (shkolla artistike)	0	2	0	2
6	Balet (shkolla artistike)	0	2	0	2
7	Biologji	4	32	13	49
8	Edukim Fizik	20	30	20	70
9	Fizikë	2	8	4	14
10	Gjeografi	2	21	2	25
11	Gjuhë Angleze	6	51	20	77
12	Gjuhë Frënge	6	9	6	21
13	Gjuhë Gjermane	0	3	0	3
14	Gjuhë Greke	0	0	4	4
15	Gjuhë Italiane	1	6	5	12
16	Gjuhë Maqedonëse	0	0	0	0
17	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	5	79	16	100
18	Histori	1	34	8	43
19	Kimi	2	9	0	11
20	Matematikë	6	45	25	76
21	Muzikë	2	4	8	14
22	Muzikë (shkolla artistike)	2	4	0	6
23	Shkenca Sociale	0	8	1	9
24	Teknologji Informacioni dhe	0	5	6	11


Komunikimi				
TOTALI Janar-Prill 2022	84	517	231	832

• **Monitorimi i procedurave të punësimit të Oficerëve të Sigurisë;**

Në bazë të Vendimit nr. 600, datë 9.10.2018 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”, në institucionet arsimore publike, ofrojnë shërbimin 150 oficer sigurie.

Shpërndarja e oficerëve të sigurisë në institucionet arsimore, në nivel DRAP është si më poshtë:

Nr.	DRAP	Numri i OS
1	Durrës	61
2	Fier	23
3	Korçë	42
4	Lezhë	24
	Totali	150



III. VEPRIMTARI MONITORUESE DHE VLERËSUESE

Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP) ka zhvilluar veprimtarinë e saj, duke zbatuar planin vjetor mbështetur në prioritetet e MAS me veprimtari, të tilla si:

- Vlerësimi i shkollës për cilësinë e shërbimit të ofruar në fushën: “Drejtimi dhe menaxhimi”;
- Vlerësimi i veprimtarisë së institucioneve të arsimit parauniversitar publik (procedurat e emerimit të mësuesve, formimi i klasave dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore);
- Vlerësimi e zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve arsimore parauniversitare private, dhe funksionimit të tyre, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
- Monitorimi i drejtuesve didaktikë në institucionet arsimore parauniversitare private;

- Vlerësimi i ZVAP për procedurat e ndjekura për Kualifikimin e mësuesve;
- Vlerësimin e veprimtarisë së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar për procedurat e emërimit të mësuesve;
- Këshillimi i drejtuesve dhe punonjësve të institucioneve arsimore e të njëjësive arsimore vendore;
- Informimi i Ministrisë, Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucioneve arsimore për gjetjet e monitorimeve dhe vlerësimeve të institucioneve arsimore;
- Inspektime bazuar në ankesa;
- Trajtim ankesash, etj.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Prauniversitar janë kryer 166 monitorime/vlerësime gjithsej gjatë periudhës janar-prill 2022.

DPAP ka trajtuar dhe ka kthyer përgjigje të ankesave që kanë ardhur në rrugë elektronike dhe me postë rreth 31 ankesa për periudhën janar-prill 2022.

IV. KURRIKULA DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

- **Vlerësimi dhe monitorimi i shërbimit psiko-social gjatë vitit shkollor 2020-2021 dhe 2021-2022**

Në kuadër të përmirësimit të dokumentacionit aktual, dhe hartimin e dokumentacionit të ri të nevojshëm për shërbimin psiko-social shkollor, është ngritur grupi i punës në bashkëpunim me ASCAP, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit psiko-social të ofruar në institucionet arsimore duke hartuar dy dokumentet bazë për funksionimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar.

- Dokumenti “Standardet e Përgjithshme Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor” është zhvilluar brenda kontekstit të çështjeve aktuale të rëndësishme për arsimin dhe aspekteve të rëndësishme psiko-sociale, duke marrë parasysh objektivat strategjike të edukimit, me vështrim vizionar në zhvillimet e ardhshme në fushën e shëndetit mendor, në nivel kombëtar dhe lokal.

- Dokumenti “Parimet për Etikën Profesionale të Shërbimit Psiko-Social Shkollor” është zhvilluar brenda kontekstit të çështjeve aktuale të rëndësishme për arsimin dhe aspekteve të rëndësishme psiko-sociale, duke marrë parasysh objektivat strategjike të edukimit, me një vështrim vizionar në zhvillimet e ardhshme në fushën e shëndetit mendor, në nivel kombëtar dhe lokal.
- Unifikimi dhe standartizimi i dokumentacionit të punonjësve të shërbimit psiko-social është i nevojshëm për ecurinë e dhe funksionimin e këtij shërbimi.

➤ **Kualifikimi i mësuesve**

Në zbatim të nenit 59 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, dhe udhëzimit nr. 4, datë 26.02.2021, “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”, u zhvilluan procedurat për organizimin e kualifikimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar, pr vitin shkollor 2021-2022, për të përfituar kategoritë e mëposhtme:


- Mësues i kualifikuar
- Mësues specialist
- Mësues mjeshër

Për vitin shkollor 2021-2022, morën pjesë në testim 2614 mësues. Të ndarë sipas DRAP jepen më të detajuar në tabelën 1.

Tabela 1

DRAP	PJESËMARRJA
DURRËS	1033
LEZHË	455
FIER	490
KORÇË	636
TOTAL	2614

Tabela 2



SHKALLA E KUALIFIKIMIT	DRAP DURRËS	DRAP FIER	DRAP LEZHË	DRAP KORÇË	Total	Total %
III	475	156	185	215	1031	39%
II	321	184	132	234	871	34%
I	237	150	138	187	712	27%
TOTAL	1033	490	455	636	2614	

Tabela 3

KATEGORIA	DRAP DURRËS	KATEGORITE NE % RANG DRAP	DRAP FIER	KATEGORITE NE % RANG DRAP	DRAP LEZHË	KATEGORITE NE % RANG DRAP	DRAP KORÇË	KATEGORITE NE % RANG DRAP	TOTAL
III	475	46%	156	32%	185	41%	215	34%	1031
II	321	31%	184	38%	132	29%	234	37%	871
I	237	23%	150	31%	138	30%	187	29%	712
	1033		490		455		636		2614

➤ Matura shtetërore 2022

Në zbatim të Urdhrit Nr. 364, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë”, do të organizohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë provimet e Maturës Shtetërore 2022, në datat:

1. **09.06.2022** – provimi i Gjuhës së Huaj (D3)
2. **11.06.2022** – provimi i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë (D1)
3. **17.06.2022** – provimi i Matematikës (D2)
4. **24.06.2022** – provimi i lëndës me zgjedhje

Mbledhja e informacionit nga katër DRAP-et Durrës, Korçë, Lezhë dhe Fier, mbi gjendjen e infrastrukturës dhe grumbullimi i informacionit mbi numrin e qendrave të provimit të përcaktuar

➤ **Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë**

Në zbatim të Udhëzimit Nr.6, datë 04.04.2022 “Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, në Republikën e Shqipërisë, viti shkollor 2021-2022”, Sesioni i parë dhe Urdhrit Nr. 72, datë 25.02.2020 “Për miratimin e Rregullores për zhvillimin e Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë në Republikën e Shqipërisë”, në datat

1. 20.06.2022 - provimi i Gjuhës Shqipe

2. 23.06.2022 – provimi i Matematikës

3. 29.06.2022 – Provimi Gjuhës së Huaj

Mbledhja e informacionit nga katër DRAP-et Durrës, Korçë, Lezhë dhe Fier, mbi gjendjen e infrastrukturës dhe numrin e qendrave të provimit të përcaktuar .

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP) do të monitorojë procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor.

➤ **Vlerësimi i arritjeve të nxënësve në Arsimin Fillor**

Në zbatim të Urdhërit Nr.78, datë 27.02.2020 “Për miratimin e rregullores për procedurat e organizimit dhe të zhvillimit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor” si dhe Udhëzimit Nr.8, date 21.04.2022 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “ Për zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor, viti shkollor 2021-2022”, më datë 23.05.2022 do të zhvillohet provimi i VANAF me nxënësit e klasave të pesta.

- Koordinimi me DRAP/ZVAP për mbledhjen e qendrave të provimit
- Monitorimi i procesit të provime të vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor, datë 23.05.2022 nga grupet e punës të ngritura në bashkëpunim me DRAP dhe ZVAP.
- Grupet e punës, në përfundim të procesit të monitorimit, do të përgatisin informacionin përmbledhës për pjesëmarrjen, ecurinë dhe problematikat e hasura gjatë procesit të provimit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor.

➤ **Ditët e informimit të maturantëve 2022**

Në vijim të shkresës zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Nr.341prot., datë 19.01.2022, “Për njohjen dhe informimin e nxënësve maturantë me institucionet e arsimit të lartë dhe programet e studimit që ato ofrojnë” dhe shkresës nr.125 prot., datë 03.02.2022, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar “Për njohjen dhe informimin e nxënësve maturantë me


institucionet e arsimit të lartë dhe programet e studimit që ato ofrojnë”, në kuadër të përgatitjeve për vitin akademik 2022-2023, u planifikua që, nga datat 22 shkurt deri më 31 mars 2022, të organizohej nisma “Ditët e informimit të maturantëve 2022”, me qëllim që institucionet e arsimit të lartë të mundësonin promovimin dhe njohjen e nxënësve maturantë me programet e tyre të studimit, që do të ofrohen në vitin akademik 2022-2023.

Sipas informacioneve të Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar, procesi ka vijuar si më poshtë:

- IAL-të kanë plotësuar kalendarin dhe ua kanë dërguar Zyrave Vendore Arsimore Parauniversitare.
- ZVAP-et pasi kanë marrë kalendarin nga çdo IAL, kanë hartuar një kalendar, duke bërë shpërndarjen sipas institucioneve të arsimit të mesëm të lartë nën juridiksionin e tyre dhe e kanë dërguar në DRAP.
- ZVAP kanë shpërndarë kalendarin me datat përkatëse si edhe linkun/linqet e takimeve online nga IAL-të, në IA nën juridiksionin e tyre.

BASHKËPUNIMI I IAL-ve ME PANAIRIN “WORK AND STUDY”

Mbështetur në shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, nr. 6809/1 prot., datë 10.02.2022, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, nëpërmjet panairit të lëvizshëm “Ëork & Study”, organizoi ditët e informimit të maturantëve për profilet e universiteteve në Zyrat Vendore Arsimore: Kukës, Dibër, Shkodër, Lezhë, Berat, Fier, Gjirokastrë, Vlorë, Durrës, Korçë, Elbasan dhe Tiranë. IAL-të, të cilat kanë bashkëpunuar me panairin e lëvizshëm “Work and Study.



➤ **Për hapjen dhe funksionimin e shkollave qendër komunitare të reja për vitin shkollor 2021-2022.**

Mbështetur në “Standardet për shkollën Qendër Komunitare Nr.1794 Prot., dt.13.03.2014 dhe kritereve të përzgjedhjes, shkresa 1794/1, datë 31.03.2014, të gjithë ZVAP që kërkuan me shkresë zyrtare, shtimin e numrit të SHQK për vitin shkollor 2021-2022, ngritën grup pune me urdhër të drejtorit të ZVAP, për monitorimin dhe verifikimin e plotësimit të kritereve për përzgjedhjen e SHQK, nën juridiksionin e tyre.

Në shtator 2021, listës zyrtare me 266 institucione arsimore të arsimit parauniversitar SHQK, iu shtuan edhe 195 institucione arsimore të arsimit parauniversitar. Tashmë janë rreth 461 shkolla që planifikojnë dhe zhvillojnë gjatë një viti mësimor veprimtari të ndryshme, që nxisin procesin e shndërrimit të këtyre institucioneve në qendra komunitare.

DRAP	SHQK 2014-2021	SHQK 2021-2022	TOTAL SHQK
DURRËS	68	45	113
KORÇË	75	61	136
LEZHË	66	55	121
FIER	57	34	91
DPAP	266	195	461

Në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve dhe unifikimit të dokumentacionit për SHQK, një nga sfidat e DPAP, u zhvillua online në janar të 2022, një takim këshillues për këtë proces.

Tashmë të gjithë shkollat si qendër komunitare do të kenë të unifikuar në structure:

- Planin e punës për veprimtaritë e SHQK
- Statistika të tilla si klubet jashtëshkollore dhe llojet e tyre, përfitues, veprimtari projekte që mbështeten nga donator
- Raportin 3 mujor dhe vjetor

Unifikimi në strukture i dokumentacionit të SHQK u trajtua dhe u shpërnda dhe për kordinatorët e 52 ZVAP-ve dhe 4 DRAP-ve.

➤ **Provimi i shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit, sesioni XVI**

Në zbatim të shkresës nr. 1451 prot., datë 03.03.2022, për zhvillimin e provimit të shtetit "Për profesionin e rregulluar të mësuesit" sezoni XVII, në bashkëpunim me DRAP dhe ZVAP u morën të gjitha masat për regjistrimin e kandidatëve të cilët:

- a) kishin kryer me sukses praktikën profesionale;
- b) kishin rezultuar jo të suksesshëm në sezonet e kaluara;
- c) nuk ishin paraqitur në sezonet e mëparshme;
- d) ishin në marrëdhënie pune dhe kishin përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në edukim.

DPAP verifikoi listat e ardhura nga DRAP, për plotësimin saktë të të dhënave si dhe për plotësimin e kriterëve ligjore për kandidatët për provimin e shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit. Për të dhënë provimin e shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit për sesionin XVII, u regjistruan gjithsej 3781 kandidatë.

DRAP	Kandidatë të regjistruar
Durrës	1426
Fier	582
Korçë	1180
Lezhë	593

Të ndarë sipas profileve kandidatë të regjistruar:

Arsim Fillor	748
Arsim special	255
Arte Figurative	23
Biologji	78
Biologji Kimi	187
Edukim Fizik	380
Fizikë	89
Gjeografi	188
Gjuhë Angleze	370
Gjuhë Frënge	54
Gjuhë Greke	3
Gjuhë Gjermane	21

Gjuhë Italiane	70
Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	392
Histori	144
Histori Gjeografi	215
Histori Gjeografi Edukatë	37
Informatikë	32
Instrumente Muzikore	28
Kimi	32
Matematikë	93
Matematikë Fizikë	127
Matematikë Informatikë	110
Shkenca Sociale	104
Gjuhë turke	1
TOTAL-	3781

➤ **Nisma Bëjmë detyrat e shtëpisë**

Nisma “ Bëjmë detyrat e shtëpisë në klasë” është një program i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit që synon të ndihmojë dhe aftësojë fëmijët në përparimin në dije dhe mundëson që nxënësi të kryejë detyrat e shtëpisë brenda mjediseve të shkollës. Gjithashtu ka si qëllim të mbështesë aftësitë shoqërore, fizike dhe intelektuale të nxënësve përmes pjesëmarrjes së tyre aktive në aktivitete të organizuara pas përfundimit të procesit mësimor.

Në zbatim të Urdhrit nr. 811, datë 14.12.2018, “Për miratimin e udhëzuesit për zbatimin e nismës “ Bëjmë detyrat e shtëpisë në klasë ”, si dhe shkresës së MASR me nr. 4512/2 prot , datë 27.09. 2021 “Mbi miratimin e përfshirjes së shkollave të reja në programin “Bëjmë detyrat e shtëpisë”, për vitin shkollor 2021-2022, pavarësisht vështirësive që u hasën, nisma u zbatua në 130 institucione arsimore, që janë nën juridiksionin e 25 ZVAP. U formuan 347 klasa mësimore, në të cilat u përfshinë 7576 nxënës dhe 801 mësues.

□ **Zgjerimi i programit “Bëjmë detyrat e shtëpisë”**

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të Arsimit dhe ZVAP-et identifikuan institucionet arsimore që mund të zbatonin programin BDSH, duke shtuar numrin e nxënësve nga institucionet e afërta arsimore në një distancë jo më shumë se 2 kilometra.

Nga informacioni i mbledhur rezulton se, vetëm 16 institucione arsimore të cilat i përkasin DRAP Korçë dhe DRAP Lezhë kanë të mundur zgjerimin e kësaj nisme me përfitues 942 nxënës.

NR.	DRAP	ZVAP	SHKOLLA EKZISTUESE E PROGRAMIT - BDSH	SHKOLLA/T E RE (LEVIZESE) PER PROGRAMIN BDSH-DERI 2KM NGA SHKOLLA EKZISTUESE	TOTAL NXËNËS
1	KORÇË	ELBASAN	QAMIL GURANJAKU	SULË HARRI	42
2	KORÇË	ELBASAN	QAMIL GURANJAKU	BARDHYL POPA	48
3	KORÇË	ELBASAN	QAMIL GURANJAKU	FEJZULLAH GURANJAKU	34
4	KORÇË	ELBASAN	QAMIL GURANJAKU	FADIL GURMANI	72
5	KORÇË	ELBASAN	LUIGJ GURAKUQI	QEMAL HAXHIHASAN 2	152
6	KORÇË	ELBASAN	LUIGJ GURAKUQI	QEMAL HAXHIHASAN 1	118
7	KORÇË	ELBASAN	LUIGJ GURAKUQI	NAIM FRASHËRI	64
8	KORÇË	ELBASAN	LUIGJ GURAKUQI	ABDYL PARALLOI	82
9	KORÇË	ELBASAN	JERONIM DE RADA	PTOLEME XHUVANI	73
10	KORÇË	ELBASAN	SULË MISIRI	JORGJI DILO	169
11	KORÇË	KUÇOVË	GAQI KARAKASHI	KOÇO KORÇARI	33
12	KORÇË	KUÇOVË	GAQI KARAKASHI	DESHMORET E KOMBIT	30
13	LEZHË	LEZHË	9-VJ"GJERGJ FISHTA"	9-VJ"KOSOVA"	18
14	LEZHË	LEZHË	9VJ-"GJERGJ FISHTA "	9-VJ"BESËLIDHJA"	7
Nxënës të parashikuar për tu përfshirë në BDSH					942

Vështrësi në zgjerimin e zbatimit të nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë”

- Prindërit nuk shfaqin interes në zbatimin e saj.
- Mungesa e transportit pasi shkollat kanë një distancë të konsiderueshme ndërmjet njëra-tjetrës.

- Institucionet arsimore janë pritëse
- Pandemia e covid-19 ka pasur ndikim edhe në vendin tonë.
- ***Ndikimet pozitive të zbatimi i nismës “Bëjmë detyrat në shkollë” në institucionet e arsimit parauniversitar:***
- Nxitjen dhe zhvillimin e interesave dhe prirjeve të nxënësve në fusha të caktuara përmes aktiviteteve jashtë kurrikulare që organizon shkolla.
- Përmirësimin e klimës dhe zhvillimin e frymës së bashkëpunimit në shkollë.
- Mbështetjen e familjeve dhe zhvillimin e partneritetit me prindërit e anëtarë të tjerë të komunitetit, për t’iu përgjigjur sa më mirë përmbushjes së nevojave fizike, emocionale dhe sociale të nxënësve si dhe për të garantuar zhvillimin e tyre të shëndetshëm.
- Sigurimin e kushteve dhe mundësive të barabarta për nxënie për të gjithë nxënësit dhe krijimin e mjedisi gjithpërfshirës që mbështet dhe nxit progresin e çdo fëmije.
- Hapësirë pasdite për të kryer detyrat e shtëpisë dhe për të bërë mësimet në shkollë.
- Përfshirjen e fëmijeve AK, Rom dhe Egjyptian në program.
- **Fëmijët e rikthyer nga zonat e konfliktit**

Në zbatim të Udhëzimit nr.10, datë 10.05.2021 për “Regjistrimin dhe mbështetjen në institucionet arsimore parauniversitare publike të fëmijëve të personave në situatë migrimi/azili, refugjatë, të fëmijëve të huaj të pa shoqëruar, të fëmijëve që kthehen nga emigracioni, nga zonat e konfliktit apo fëmijë, viktima të trafikimit, në Republikën e Shqipërisë.”

Gjatë gjithë periudhës shtator 2021–prill 2022 është kryer regjistrimi në shkollë i të gjithë fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit. Qëllimi kryesor ka qenë të lehtësohet procesi i integritit dhe të rriten aftësitë sociale.

Pas regjistrimit, për secilin nxënës është kryer testimi i njohurive në të gjitha lëndët, si dhe aftësitë në të folur dhe të shkruar, në mënyrë që të lehtësohet puna me këta fëmijë.

Drejtoritë e shkollave kanë raportuar për problematika të integritit dhe ecurinë e këtyre fëmijëve në mënyrë periodike, gjithashtu me mbështetjen dhe koordinimin e CVE janë zhvilluar sesione informuese me mësuesit e shkollave ku këta fëmijë janë riintegruar. Rezultatet janë pasqyruar edhe në arritjet e deri tanishme të këtyre nxënësve.

➤ **Regjistrimi i fëmijëve ukrainas**

Në zbatim të urdhrit nr.185, datë 06.04.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për arsimimin e përkohshëm dhe mbështetjen psiko-sociale të fëmijëve të ardhur për shkak të luftës nga Republika e Ukrainës.” dhe referuar informacionit të marrë nga Ambasada e Republikës së Ukrainës në Shqipëri, deri në datën 6 maj 2022 në vendin tonë janë 327 fëmijë të moshës 3-17 vjeç. Këta fëmijë aktualisht zhvillojnë mësimin online në shkollat e tyre në Republikën e Ukrainës.

1. Aktualisht në shkollat tona publike dhe private, deri më datë 09.05.2022, janë regjistruar 12 fëmijë ukrainas, nga të cilët 4 në arsim privat dhe 8 në arsim publik, sipas ZVAP-ve;

- a) ZVAP Tiranë: 6 (gjashtë) fëmijë, 3 arsim privat, 3 arsim publik;
- b) ZVAP Durrës: 1(një) fëmijë, arsim privat
- c) ZVAP Vlorë – Himarë: 2(dy) fëmijë, arsim publik;
- d) ZVAP –Sarandë Delvinë Konispol: 3(tre) fëmijë, arsim publik;

2. Më poshtë gjeni një informacion mbi veprimtarinë e ZVAP-ve në bashkëpunim dhe koordinim me grupin e punës:

- a) ZVAP Tiranë: 6 (gjashtë fëmijë) sipas interesave të shfaqura nga vetë prindërit e tyre për përzgjedhjen e klasës të cilët ata frekuentojnë.
- b) ZVAP Durrës, është kontaktuar me të gjithë personat që janë në listën e përcjellë nga Ambasada Ukrainase. Familjet janë vendosur pranë zonës së Plazhit, Durrës dhe komunikimi me ta është bërë nëpërmjet një mësuese të gjuhës ruse. Prindërit konfirmojnë se fëmijët i përkasin moshës 3-10 vjeç dhe ata ndjekin mësimin online të përgatitur nga mësuesit e tyre ukrainas, ndërkohë që pranojnë se nëse lufta do të zgjasë ata do t’i regjistrojnë fëmijët e tyre në shkollat tona në fillim të vitit shkollor 2022-2023.

Shkollat 9–vjeçare të cilat janë përcaktuar për pritjen e këtyre nxënësve deri tani janë shkolla 9–vjeçare “Bajram Curri” dhe shkolla 9–vjeçare “Abedin Dino”, të dyja në zonën e Plazhit. Gjithashtu është njoftuar edhe Bashkia Durrës për fëmijët të cilët i përkasin grup moshës 3-6 vjeç, për sistemimin e tyre në kopshte, por deri tani nuk ka pasur interes nga prindërit e fëmijëve të kësaj grup moshe. ZVAP Durrës konfirmon se është kontaktuar dhe me organizatën Eorl Vision, ku menaxherja e projektit të kësaj shoqate në Durrës , ofroj mbështetjen për ndihmë sipas planifikimeve të bëra.

- c) ZVAP Vlorë–Himarë janë regjistruar 2(dy) fëmijë në shkollën 9–vjeçare “Avni Rustemi” dhe mësimi vijon normalisht me të dy nxënësit. Nxënëset nga datat e paraqitjes në shkollë dhe deri më sot janë integruar shumë mirë dhe kanë filluar të përvetësojnë gjuhën shqipe duke punuar me Abetaren dhe

arrijnë të flasin fjalë shqip. Ndërsa në Matematikë ato punojnë lehtësisht pasi e kanë përvetësuar shumë mirë, për shkak të ngjashmërisë së lëndës.

- d) ZVAP–Sarandë Delvinë Konispol janë regjistruar 3(tre) fëmijë dhe me këta fëmijë punohet më shumë në lëndën e matematikës pasi në lëndët e tjera kanë vështirësi në komunikim.
- e) ZVAP Kavajë konfirmon se fëmijët e vendosur në qytetin e Kavajës deri më tani, zhvillojnë mësimin online me mësuesit ukrainas.
- f) ZVAP Elbasan nuk është regjistruar asnjë fëmijë. Nga lista e përcjellë nga Ambasada Ukrainase fëmijët janë të një grup moshës 0-6 vjeç që janë vendosur në qytetin e Elbasanit.

V. BASHKËPUNIME INSTITUCIONALE

Gjatë vitit 2021 DPAP-ja ka bashkëpunuar me institucionet MAS, ASCAP, DRAP dhe ZVAP duke dhënë sugjerime për:

- Rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë.
- Udhëzimin Nr.12, datë 10.06.2021 “ Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimi e portalit “ Mësues për Shqipërinë”,
- Udhëzimin Nr.2, datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”.
- Vlerësimin e Kartës së performancës së shkollës,
- Standardet profesionale të vlerësuesit të institucioneve të arsimit parauniversitar,
- Për disa ndryshime në urdhërin nr.234, datë 19.04.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar”
- Draft rregulloren e Maturës Shtetërore dhe Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë.
- Amzën digjitale apo mënyrën e regjistrimit të nxënësve në klasën e parë dhe të dhjetë të arsimit bazë.
- Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.

- Për disa ndryshime në VKM nr. 682, datë 29.07.2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, të ndryshuar .

Për periudhën Janar-Prill 2022 Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar ka zbatuar politikën menaxheriale duke u fokusuar në nevojat e domosdoshme dhe duke u përqëndruar në përgjegjësitë funksionale të saj, të cilat konsistojnë në:

- 1. Ofrimin e një shërbimi cilësor në sistemin arsimor parauniversitar nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit.*
- 2. Organizimin e punës për menaxhimin , ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.*
- 3. Koordinimin e administrimit të burimeve njerëzore në sistemin arsimor parauniversitar sipas legjislacionit në fuqi.etj.*

Në periudhën në vazhdim DPAP do të vazhdojë punën për zbatimin me rigorozitet të politikave të institucionit dhe realizimit të objektivave e synimeve kryesore.